



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT VLORE

Nr. 62/ prot.

Vlorë, më 16. 01 . 2025

Lënda: Shprehje për ligjshmërinë e akteve të Këshillit të Bashkisë Finiq

KËSHILLIT BASHKIAK FINIQ

Për dijeni:

KRYETARIT TË BASHKISË FINIQ

Në vijim suajës me nr. 67 prot., datë 10.01.2025, protokolluar pranë institucionit tonë me nr.62 prot., datë 13.01.2025, si dhe në mbështetje dhe zbatim të neneve 8 dhe 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, shprehemi si më poshtë vijon:

1. Vendimi i Këshillit Bashkiak Finiq nr.40, datë 23.12.2024 “Për miratimin e planit të aktiviteteve për vitin 2025 të këshillit bashkiak”, **vlerësohet i ligjshëm.**
2. Vendimi i Këshillit Bashkiak Finiq nr.41, datë 23.12.2024 “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i bashkisë për periudhën nëntor-2024”, **bazuar në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, neni 3/1(a), akti ka karakter individual.**
3. Vendimi i Këshillit Bashkiak Finiq nr.42, datë 23.12.2024 “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i bashkisë për periudhën dhjetor-2024”, **bazuar në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, neni 3/1(a), akti ka karakter individual.**
4. Vendimi i Këshillit Bashkiak Finiq nr.43, datë 23.12.2024 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 01-31/10/2024”, **bazuar në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, neni 3/1(a), akti ka karakter individual.**
5. Vendimi i Këshillit Bashkiak Finiq nr.44, datë 23.12.2024 “Për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 01-31/11/2024”, **bazuar në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, neni 3/1(a), akti ka karakter individual.**



BASHKIA FINIQ

PLANI I INTEGRITETIT

2025-2027

Miratur me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 49, datë 23/12/2024



REPUBLIKA E SHQIPËRIE

BASHKIA FINIQ

KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 49 datë 23/12/2024

“Miratimi i Planit të Integritimit 2025-2027”.

Në mbështetje të Ligjit 139/2015, ‘Për vetëqeverisjen vendore’, Ligjit nr.152/2013, ‘Për nënpunësin civil’, i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015, ‘Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë’, Ligjit nr.10296/2010, ‘Për menaxhimin financiar dhe kontrollin’, i ndryshuar, Ligjit nr.9131/2003, ‘Për rregullat e etikës në administratën publike’, i ndryshuar, Ligjit nr. 9367/2005, ‘Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksionit shtetëror’, Ligjit nr.146/2014, ‘Për njoftimin dhe konsultimin publik’, Ligjit 119/2014, ‘Për të drejtën e informimit’, Vendimin nr. 247 datë 20/03/2015 të KM-ve, ‘Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit për periudhën 2015-2020 dhe miratimin e planit të veprimit 2020-2023’, në zbatim të strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit 2015-2023 e të pasaportës së indikatorëve, Sekretari i Përgjithëshëm, drejtoria Juridike i propozojnë këshillit bashkiak që në mbledhjen e radhës të miratojnë Planin e Integritimit për 2025-2027. Këshilli bashkiak në mbledhjen e radhës datë 23/12/2024:

VENDOSI

1-Miratimin e Planit të Integritimit 2025-2027 për bashkinë Finiq, i cili është pjesë integrale e këtij vendimi.

2-Ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi të gjitha drejtoritë përkatëse të bashkisë Finiq.

3-Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit 139/2015, neni 55, pika 6 si dhe pas shprehjes së ligjeshmërisë nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë.

KRYETARI I KËSHILLIT

Thoma KALLOJERI

Adresa: 9716, Finiq, Vlorë

www.bfiniq.gov.al

Email: bashkia.finiq@gmail.com





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FINIQ
SEKRETARI I PERGJITHSHEM
DREJTORIA JURIDIKE

Nr ____ Prot

Datë ____ / ____ / 2024

RELACION

Plani i Integritetit 2025-2027 është një dokument i brendshëm strategjik anti-korrupsion, i cili synon të kontribuojë në forcimin e integritetit institucional, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së bashkisë, si dhe mundësimin e shërbimeve më cilësore për qytetarët.

Planifikimi i integritetit është një proces shumë i rëndësishëm që lejon institucionet e qeverisjes vendore dhe qytetarët që ajo përfaqëson, të luftojnë sjelljet jo etike, jo-profesionale dhe korruptive në institucion. Ky Plan Integriteti është një dokument operacional që do të drejtojë veprimtarinë e Bashkisë Finiq drejt zhvillimit të një administrate vendore të përgjegjshme, llogaridhënëse dhe transparente.

Hartimit i Planit të Integritetit në Bashkinë Finiq, u realizua përmes një procesi gjithëpërfshirës. Punonjësit e bashkisë dhe drejtuesit kontribuan në vlerësimin e riskut të integritetit dhe propozimin e masave për përmirësimin e integritetit dhe reduktimin apo eliminimin e risqeve të integritetit për procese apo funksione të veçanta në institucion.

Ky proces përfshiu analizën e risqeve të integritetit për proceset e punës në fushat funksionale të bashkisë: i) Fusha e menaxhimit financiar; ii) Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore; iii) Fusha e kontrollit, auditimit dhe të mekanizmave kundër korrupsionit; iv) Fusha e shërbimeve publike; v) Fusha e administrimit dhe menaxhimit të pronave; vi) Fusha e planifikimit, administrimit dhe zhvillimit të territorit; dhe vii) Fusha e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve si dhe të informacionit, dhe të dokumenteve elektronike.

Objektivat kryesore të Planit të Integritetit të Bashkisë Finiq janë:

1. Përmirësimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit
2. Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore të bashkisë me aftësi të nevojshme për identifikimin, vlerësimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit
3. Rritja e transparencës dhe ndërveprimit me publikun
4. Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë Finiq.

Nëpërmjet miratimit të këtij akti, Bashkia Finiq angazhon për ndjekjen dhe zbatimin e tij të gjitha drejtoritë përkatëse përgjatë 2025-2027.

DREJTORIA JURIDIKE
Eduart Mërkuri

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Vangjel Xhaferi

KRYETARI
Romeo ÇAKULI

Adresa: 9716, Finiq Vlore

Email: bashkia.finiq@gmail.com



GRUPI I PUNËS PËR HARTIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT NË BASHKINË FINIQ

Sotir Davella, Koordinator i Grupit të Punës, Drejtoria e Strehimit dhe Asistencës Sociale
Eduart Merkuri, Drejtor i Drejtorisë Juridike
Zhaklina Boro,
Ilia Nikolla,
Aristotel Mitro,
Irena Eksarho,
Ziso Karkashina,
Lefteria Mekshi,
Vasil Loli

GRUPI I PUNËS AMVV

Majlinda Riska, Eksperte për Etikën dhe Integritetin
Julian Uzeir, AMVV

Ky plan integriteti është hartuar në kuadër të Komponentit "Zgjerimi i praktikës standarde të planifikimit të integritetit në nivel vendor" "Mbështetja dhe avancimi i reformave të qeverisjes vendore", në bashkëpunim me AMVV dhe me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor

DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL


Integriteti dhe transparencia janë elemente thelbësore për ndërtimin e një pushteti vendor të drejtë, të ndershëm dhe të orientuar drejt përmirësimit të qeverisjes demokratike. Bashkia Finiq ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit, një dokument strategjik që synon forcimin e mekanizmave të llogaridhënies dhe përmirësimin e shërbimeve publike.

Hartimi i këtij plani ka ardhur si rezultat i një procesi të mirëstrukturuar, gjatë të cilit janë identifikuar dhe analizuar risqet që mund të cenojnë funksionimin e drejtë të administratës vendore. Ky dokument përfshin masa konkrete për parandalimin e shkeljeve të integritetit dhe rritjen e transparencës në të gjitha aspektet e qeverisjes vendore.

Përkushtimi ndaj transparencës dhe etikës është vendimtar jo vetëm për përmirësimin e qeverisjes vendore, por edhe për të mbështetur përpjekjet e Shqipërisë në rrugën drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Bashkia Finiq angazhohet të zbatojë në mënyrë efektive këtë plan, duke krijuar një administratë të hapur dhe të përgjegjshme, e cila kontribuon në konsolidimin e qeverisjes demokratike dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit.

Bashkia Finiq riafirmon angazhimin e saj për të qenë një shembull i qeverisjes transparente dhe të orientuar drejt zhvillimit të qëndrueshëm, duke kontribuar në forcimin e demokracisë dhe integritimin e vendit në Bashkimin Evropian.

Romëo ÇAKULI,
Kryetar i Bashkisë Finiq



SHKURTESA

AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
BNJ	Burime Njerëzore
DAP	Departamenti i Administratës Publike
GPI	Grupit të Punës për Integritetin
KI	Konflikti i Interesit
NJVV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
PBA	Planifikimi Buxhetor Afatmesëm
PI	Plani i Integritetit
PPV	Plan i Përgjithshëm Vendor
PSV	Procedura Standarde Veprimi

TABELA E PËRMBAJTJES

<u>1. Rëndësia e Planit të Integritetit</u>	6
<u>1.1 Procesi i hartimit të Planit të Integritetit</u>	6
<u>1.2 Qasja metodologjike</u>	8
<u>2. Objektivat e identifikuara dhe niveli i përgjithshëm i cënueshmërisë së integritetit</u>	9
<u>3. Plani i veprimt</u>	
11	

1. Rëndësia e Planit të Integritetit

Plani i Integritetit paraqet një mekanizëm të rëndësishëm strategjik dhe operacional, i cili ka si qëllim kryesor forcimin e etikës dhe integritetit institucional në Bashkinë Finiq. Ky dokument është rezultat i një procesi të detajuar dhe gjithëpërfshirës, që fokusohet në vlerësimin e riskut të integritetit brenda administratës lokale.

Gjatë këtij procesi, janë përcaktuar të gjitha funksionet dhe pozitat e punës që preken më së shumti nga rreziqe të ndryshme, përfshirë veprimet korruptive, sjelljet joetike ose profesionale, si edhe parregullsitë tjera që mund të dëmtojnë reputacionin e institucionit. Kjo analizë thelbësore siguron një kuptim më të thellë mbi sfidat me të cilat përballlet bashkia në ruajtjen e standardeve etike.

Duke u fokusuar në identifikimin e këtyre risqeve specifike, Plani i Integritetit krijon një bazament solid për zhvillimin e politikave dhe procedurave që ndihmojnë në parandalimin e korrupsionit dhe promovimin e transparencës brenda strukturave administrative. Gjithashtu, ai angazhon çdo punonjës duke u ofruar atyre mjetet dhe udhëzimet e nevojshme për t'u marrë me situata potencialisht problematike.

Në këtë mënyrë, plani nuk është thjesht një dokument formal; ai shpreh angazhimin serioz të Bashkisë Finiq për krijimin dhe ruajtjen ofrimit shërbimeve me integritet ndaj qytetarëve. Kjo nënkupton se çdo veprim administrativ do të bazohet mbi principe etike solide duke rritur kështu besueshmërinë tek publiku si edhe forcimi i marrëdhënieve ndërmjet institucioneve qeveritare dhe qytetarëve.

Plani i Integritetit për Bashkinë Finiq ka rëndësi të veçantë për disa arsye kryesore:

- **Forcimi i Integritetit Institucional:** Ky plan kontribuon në konsolidimin e integritetit institucional duke vendosur standarde etike dhe profesionale të larta për punonjësit dhe drejtuesit.
- **Parandalimi i Korrupsionit:** Duke identifikuar dhe vlerësuar risqet ndaj integritetit, plani ndihmon në shmangien e praktikave korruptive si edhe parregullsive, duke forcuar besimin publik në administratën lokale.
- **Rritja e Transparencës dhe Llogaridhënies:** Plani inkurajon transparencën dhe llogaridhënien në gjitha aktivitetet e bashkisë, duke siguruar që vendimet janë publike dhe arsyetuar siç duhet.
- **Menaxhimi Efektiv i Burimeve Njerëzore:** Ai gjithashtu fokusohet në zhvillimin dhe menaxhimin optimal të burimeve njerëzore me aftësi kritike për identifikimin, vlerësimin si edhe parandalimin e risqeve lidhur me integritetin, kështu sigurohet një administratë më kompetente.

- Përmirësimi i Shërbimeve ndaj Qytetarëve: Përmes rritjes së etikës dhe integritetit brenda administratës, plani kontribuon në ofrimin e shërbimeve cilësore etike ndaj qytetarëve të Finiqit.
- Ndërveprimi Më Efektshmëri me Publikun: Duke rritur transparencën si edhe angazhuar publikun aktivisht, plani ndihmon në krijimin e një marrëdhënieje më solide mes bashkisë dhe komunitetit.
- Menaxhimi Proaktiv i Riskut: Planu gjithashtu adreson menaxhimin proaktiv të riskut lidhur me integritetin në fusha specifike përgjegjëshmërie. Kjo qasje lejon identifikimin paraprak të risqeve para se ato t'i shkaktojnë probleme institucionale.

Bashkia Finiq ka zbatuar një proces gjithëpërfshirës planifikimi sipas fushave dhe funksioneve. Ky vlerësim përfshiu analizën e detajuar të proceseve të punës në drejtoritë ashtu sikurse njësitë që janë me tepër të ekspozuara ndaj praktikave korruptive ose sjelljeve joetike apo parregullsive të tjera.

Planu i Integritetit është përgatitur duke u mbështetur në analizën dhe rekomandimet e punonjësve të bashkisë dhe ekspertëve të Agjencisë për mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), në kuadër të zbatimit të dokumentit të Metodologjinë për Vlerësimin e Riskut të Integritetit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Planu synon realizimin e objektivave të mëposhtëm:

- Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe strategjik në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit;
- Forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit nëpërmjet menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore në bashki;
- Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies së bashkisë;
- Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të riskut të integritetit me fokus në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë.
- **1.1 Procesi i hartimit të Planit të Integritetit në Bashkinë Finiq**

Hartimi i Planit u realizua nga një Grup Punë i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë (.....), i përbërë nga përfaqësues të administratës, të cilët u asistuan nga AMVV. Procesi zgjati nga shtatori deri në dhjetor 2024.

Hartimi i Planit të Integritetit në Bashkinë Finiq kaloi në fazat e mëposhtme:

Faza 1: Përgatitja, komunikimi dhe mobilizimi i burimeve njerëzore

Plani i Integritetit funksionon si një instrument vetëvlerësimi për institucionin dhe si një strategji tërësore masash të dizajnuara për të adresuar sfidat specifike që lidhen me integritetin dhe etikën. Kjo nismë është e rëndësishme, pasi ndihmon në identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve që mund të dëmtojnë reputacionin e institucioneve publike.

Hapi i parë në procesin e krijimit të këtij plani ishte ngritja e një grupi pune, i cili ka përfaqësues nga administratën e bashkisë. Ky grup kishte në përbërjen e tijë punonjës nga fushat kryesore të funksioneve administrative dhe luan një rol kyç në analizimin dhe vlerësimin e sfidave me të cilat përballlet institucioni.

Përpara se grupi i punës të niste punën, ai u prezantua me Metodologjinë për Vlerësimin e Riskut të Integritetit, specifikisht përshtatur për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Kjo metodologji ofron një strukturë sistematike që ndihmon në identifikimin, analizën dhe trajtimin efektiv të rreziqeve potenciale që janë më së shumti prezent në administratë.

Për t'u siguruar që anëtarët e grupit kishin njohuritë thelbësore mbi etikën dhe integritetin në sektorin publik, ata iu nënshtruan trajnimeve intensive. Rritja e kapaciteteve kontribuon jo vetëm në forcimin individual të çdo anëtari por gjithashtu ndihmon në krijimin e një kulture organizative ku integriteti është vlera kryesore.

Në fazën finale, grupi i punës realizoi komunikime gjithëpërfshirëse mbi objektivat dhe qëllimet kryesore të Planit të Integritetit me gjithë administratën lokale. Ky komunikim u fokusua gjithashtu edhe tek angazhimi aktiv i stafit gjatë gjithë procesit; duke inkurajuar pjesëmarrjen aktive nga çdo individ brenda bashkisë. Si rezultat, kjo strategji jo vetëm që rrit ndërgjësimin mbi rëndësinë e këtij dokumenti strategjik por gjithashtu forcon angazhimin kolektiv ndaj ruajtjes së standardeve më të larta etike brenda institucionit.

Faza 2: Identifikimi dhe analizimi risqeve të integritetit

Grupi i punës shqyrtoi kornizën rregullatore, strategjike si dhe dokumente të ndryshme operative të bashkisë. Gjithashtu, u analizuan të dhëna nga performanca, monitorimi dhe zbatimi i aspekteve të veçanta të integritetit në institucion. Grupi i Punës vijoi me identifikimin dhe analizimin e risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre, për proceset e punës në fushat funksionale të bashkisë. Me qëllim mbledhjen e të dhënave cilësore, në këtë fazë u zhvilluan 7 grupe të fokusuara diskutimi me punonjësit e bashkisë sipas fushave të kompetencave të përgjithshme dhe funksionale. Në këtë fazë, punonjësit e administratës plotësuan një pyetësor në mënyrë anonime, në formë elektronike për të siguruar të dhëna dhe informacione për vlerësimin e sistemit të menaxhimit të integritetit. Ky pyetësor u plotësua nga 42 përfaqësues të administratës së bashkisë.

Faza 3: Vlerësimi i risqeve të integritetit

Grupi i Punës në bashkëpunim me punonjësit dhe ekspertët e AMVV bëri vlerësimin e risqeve të integritetit. Risqet e identifikuara u vlerësuan në lidhje me:

- Mundësinë e ndodhjes së një ngjarjeje të padëshiruar kur nuk ka aktivitete kontrolli ose kur ato janë të pamjaftueshme për të parandaluar apo ulur riskun;
- Pasojën që një ngjarje e padëshiruar do të kishte në bashki nëse do të ndodhte.

Bazuar në mundësinë së ndodhjes dhe ndikimin e tyre, risqet u kategorizuan në nivele të ndryshme (i lartë, mesatar, i ulët) dhe u renditën sipas prioritetit.

Faza 4: Plani i masave për menaxhimin e integritetit

Procesi i identifikimit dhe vlerësimit të risqeve të integritetit është një hap i rëndësishëm për rritjen e ndërgjegjësimit të stafit mbi problematikat që hasen gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre. Nga analiza e të dhënave rezultoi se Bashkia Finiq ka nevojë për plotësimin e kuadrit rregullator për etikën dhe integritetin, në kapacitete njerëzore, financiare dhe teknike për zbatimin e objektivave të saj strategjik që sigurojnë transparencë dhe llogaridhënie ndaj qytetarëve, por edhe faktorë të tjerë risqesh që lidhen me ofrimin e shërbimeve apo kryerjen e funksioneve të veta ndaj qytetarëve. Në përfundim të fazës së renditjes së risqeve sipas prioriteteve, Grupi i Punës diskutoi mbi hartimin e një plani me masa konkrete për adresimin e risqeve të evidentuara. Ky Plan Veprimi përfshin tërësinë e masave për të adresuar risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit të identifikuar sipas fushave të përgjegjësive së bashkisë Finiq, afatet kohore dhe strukturat përgjegjëse. Ai është një mjet plotësues i politikave dhe kornizës rregullatore për përmirësimin dhe forcimin e integritetit institucional.

Plani i Integritetit do të fillojë zbatimin pas miratimit nga Këshilli Bashkiak.

1.2 Qasja Metodologjike

Hartimi i Planit të Integritetit për Bashkinë Finiq u realizua në përputhje me metodologjinë për vlerësimin e riskut në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, duke ndjekur një qasje të kombinuar cilësore dhe sasiore.

Instrumentet cilësore përfshijnë:

1. Analizën e kuadrit të brendshëm rregullator:

Kjo analizë shqyrton nëse bashkia ka zbatuar kërkesat ligjore dhe rregulloret e brendshme, duke përfshirë:

- Përshkrimet e punës dhe zinxhirin e llogaridhënies;
- Rregullat për etikën dhe parandalimin e konfliktit të interesit;
- Urdhrat për procedurat që lidhen me integritetin.

2. Diskutimet me stafin e bashkisë në grupe të fokusuara

Gjatë fokus grupeve trajtohen problematikat që mund të përbëjnë risk për integritetin gjatë praktikës së punës së tyre, si nevojat për trajnim dhe kualifikime shtesë, apo mangësi në burimet financiare.

Metoda tjetër e përdorur ishte ajo sasiore, përmes vlerësimit me anë të një pyetësori të strukturuar, i cili përfshinte pyetje të fokusuara në çështje të veçanta të integritetit dhe etikës në administratën e bashkive. Ky instrument kishte për qëllim të matë perceptimet e nëpunësve të bashkive lidhur me funksionimin dhe efektivitetin e sistemit të menaxhimit të integritetit. Pyetësori u plotësua në mënyrë anonime për të garantuar lirinë e shprehjes dhe besueshmërinë e rezultateve.

Procesi i anketimit përfshiu një kampion prej 26 nëpunësish bashkiakë, bazuar në parimin e përzgjedhjes dhe raportimit vullnetar nga popullata e synuar.

Nga aspekti gjinor, zyrtarët meshkuj përbëjnë 46.2% të kampionit, ndërsa zyrtaret gra përfaqësojnë 53.8%. Sa i përket grupmoshave, kategoria më e përfaqësuar është ajo e moshës mbi 56 vjeç (38.5%), e ndjekur nga grupmosha 36- 45 vjeç me 23.1%. Grupmosha 26-35 vjeç përbën 19.2%, dhe grupmosha 46-55 vjeç përbën 15.4%. Sa i përket grupmoshës deri në 25 vjeç, përbën vetëm 3.8% të kampionit.

Në aspektin e përvojës profesionale, nëpunësit me 5- 10 vite përvojë pune përbëjnë 42.3% të kampionit. Kategoria me më pak se 5 vite përvojë përbën 38.5%, ndërsa kategoria me 11-20 vite përvojë përfaqëson 11.5%. Kategoria më pak e përfaqësuar është ajo me mbi 30 vite përvojë me 7.7%.

2. Objektivat e identifikuara dhe niveli i përgjithshëm i cënueshmërisë së integritetit

2.1 Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe strategjik në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit

Me qëllim forcimin e mekanizmave të etikës dhe integritetit, bashkia do të angazhohet në forcimin e kuadrit të brendshëm rregullator dhe institucional. Ky objektiv synon forcimin e kuadrit të brendshëm rregullator nëpërmjet rishikimit të dokumenteve të brendshme aktuale apo miratimit të dokumenteve të reja për adresimin e aspekteve të veçanta të etikës dhe integritetit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe politikën për vetëqeverisjen vendore. Kjo përfshinë:

- Miratimin e një rregulloreje të brendshme të përditësuar në përputhje me strukturën e re.
- Hartimin, konsultimin dhe miratimin e Planit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Finiq dhe publikimin e tij në Programin e Transparencës.
- Hartimin e strategjive specifike dhe zbatimin e procedurave ligjore që lidhen me etikën dhe integritetin.
- Mundësimi i trajnimit të personelit të Auditit të Brendshëm me qëllim marrjen e certifikimit përkatës, etj.
-

Pavarësisht se Bashkia Finiq ka miratuar Rregulloren e Administratës së saj, kjo rregullore është e papërditësuar me ndryshimet në strukturën e fundit të Bashkisë dhe nuk parashikon përshkrimet e të gjitha pozicioneve të punës dhe linjave hierarkike përkatëse. Nga ana tjetër, rregullorja nuk është në linjë me kuadrin ligjor në fuqi për etikën në Republikën e Shqipërisë. Bashkia ka patur mangësi edhe në përmbushjen e kuadrin rregullator që ngre strukturat dhe zbërthen kuadrin ligjor për parandalimin e konfliktit të interesit dhe për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në kontekstin e bashkisë. Në këtë kuadër, administrata e bashkisë angazhohet se do të sigurojë rishikimin e kuadrit të brendshëm rregullator për etikën dhe integritetin, të cilat do të bëhen pjesë e sesioneve trajnuese të punonjësve të bashkisë nga strukturat përgjegjëse pas miratimit të tyre.

Këto masa janë përfshirë në Planin e Veprimit dhe janë pjesë e angazhimit të bashkisë për minimizimin e risqeve të identifikuara brenda një periudhe afatmesme.

2.2 Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit

Forcimi i proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion do të sigurojë kapacitete dhe aftësi të nevojshme për të zbatuar dhe konsoliduar mekanizmat garantues të integritetit në institucion. Ky objektiv synon rritjen e profesionalizimit të personelit dhe zhvillimin në karrierë të zyrtarëve në përputhje me performancën në punë. Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, u konstatua se Bashkia Finiq përballej me sfida në disa aspekte të burimeve njerëzore, përfshirë:

- Domosdoshmëria e plotësimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore.
- Nevoja për trajnime të stafit të ri dhe të atij ekzistues.
- Plotësimi i manualit të përshkrimeve të punës për çdo pozicion pune në bashki.
-

Përveç kësaj, u identifikuan kërkesa specifike për trajnim, veçanërisht në fushat e financave dhe prokurimeve publike, procesin e rekrutimit të punonjësve duke respektuar në mënyrë rigoroz procedurat e ligjit “Për Shërbimin Civil,” si dhe procese specifike në lidhje me menaxhimin, zhvillimin e aseteve.

2.3 Përmirësim i transparencës dhe llogaridhënies së bashkisë.

Një nga aspektet kryesore të qeverisjes demokratike është transparenca dhe përfshirja e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Kjo garanton që publiku dhe grupe të tjera me interes të jenë të informuara rreth mënyrës se si bashkia përmbush nevojat e komunitetit dhe i ofron mundësinë për të marrë pjesë drejtpërdrejt në vendimmarrje përmes proceseve konsultuese.

Nga analiza e rreziqeve u vlerësua se, ndonëse Bashkia Finiq ka bërë përpjekje për t'u angazhuar proaktivisht në ndarjen e informacionit me publikun, programi i transparencës ka ende mangësi në ndarjen proaktive të informacionit me publikun pasi zërat e programit të transparencës pavarësisht plotësimit të tyre, kishin nevojë për t'u përditësuar dhe plotësuar me informacione më të plota dhe më të detajuara.

Duke qenë të vetëdijshëm për këto problematika, këto risqe u përfshinë në planin e veprimit, duke synuar t'i reduktonin ato brenda një periudhe afatshkurtër.

2.4 Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të riskut të integritetit me fokus në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë;

Ky objektiv synon menaxhimin e riskut të integritetit në fushat kryesore të përgjegjësisë së bashkisë, duke u orientuar drejt atyre proceseve pune që janë më të ndjeshme ndaj korrupsionit. Menaxhimi i integritetit në Bashkinë Finiq sjell me vete disa sfida, kryesisht në fusha të caktuara si menaxhimi financiar, auditimi, mbledhja e taksave vendore, administrimin e pronave publike, ofrimi i shërbimeve publike, planifikimi i territorit. Sigurimi i fondeve të mjaftueshme për reduktimin e këtyre rreziqeve paraqet një sfidë të madhe për bashkinë dhe kërkon një angazhim të madh për t'i arritur. Kjo është thelbësore për t'u siguruar që qytetarët kanë akses në shërbime me standarde uniforme

Në lidhje me fushat e veçanta të përgjegjësisë së bashkisë, u identifikuan një sërë risqesh në menaxhimin financiar, të cilat lidhen me kapacitetin e Bashkisë Finiq për të realizuar në mënyrë efektive shpenzimet dhe të ardhurat e saj. Këto risqe kërkojnë një mirëplanifikim dhe koordinim të hollësishëm në nivel programesh, si dhe pajisjen e bashkisë me programet digjitale të nevojshme për menaxhimin financiar.

Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet se Bashkia Finiq ka nevojë për të kryer rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor pasi përballet me problematika të shumta lidhur me regjistrimin e pronave të sajë dhe shfrytëzimin e zonave me kapacitet ekonomik si pasojë e burimeve njerëzore të pamjaftueshme sipas kërkesave të kuadrit rregullator, sidomos në fushën e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit. Për më tepër, bashkia përballet me mungesa financiare dhe teknike për të realizuar detyrat funksionale në terren që lidhen me administrimin e pronave dhe planifikimin e territorit.

Sigurimi i fondeve të nevojshme për të adresuar këto risqe mbetet një sfidë që shkon përtej kapacitetit të bashkisë, duke kërkuar një angazhim dhe vullnet të fortë për zbatimin e kuadrit ligjor rregullator. Kjo është thelbësore për të garantuar që qytetarët të kenë akses në shërbime me standarde të njëjta në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Plani i Veprimit

Plani i Veprimit përfshin një sërë masash të strukturuar për të adresuar risqet e identifikuar në Bashkinë Finiq. Ky plan shërben si një instrument plotësues i politikave dhe kuadrit rregullator, duke synuar përmirësimin dhe forcimin e integritetit institucional.

Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të Planit të Veprimit kryhet në mënyrë periodike, çdo vit. Ky proces pasqyron përmbushjen e aktiviteteve nga punonjësit ose grupet e punonjësve përgjegjës për zbatimin e masave të miratuara. Monitorimi ka për qëllim të vlerësojë efikasitetin e masave të ndërmarra dhe të identifikojë nëse ka pasur ndryshime në kontekstin institucional apo në natyrën e risqeve. Këto ndryshime mund të diktojnë nevojën për rishikimin e masave ekzistuese, ri-prioritizimin e risqeve dhe përmirësimin e planifikimit në të ardhmen.

Procesi gjithashtu synon të nxjerrë mësim nga përvoja për të mundësuar një qasje më të mirë dhe më të qëndrueshme në planifikimin e masave të integritetit në të ardhmen.

Objektivi 1: Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të Etikës dhe Integritetit.					
Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut	Prioritetet i lartë; Prioritetet i moderuar; Prioritetet i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteve
1	Miratimi i Rregullores së brendshme të bashkisë të përditësuar me strukturën e re organike.	Operacionet (Procesi)		1. Përditësimi (dhe miratimi) i rregullores së bashkisë me strukturën aktuale. 2. Përcaktimi i plotë dhe i qartë në rregullore i detyrave dhe linjave të komunikimit dhe hierarkisë ndërmjet strukturave të bashkisë.	Kryetari/Grup Pune Gjashtëmujori i parë 2025
2	Nevoja për rishikimin Planit të Përgjithshëm Vendor	Operacional/ligjor	Mesatar	1. Miratimi i PPV.	Kryetari/Grup Pune Gjashtëmujori i dytë i 2025
3	Mungesa e një Plani Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Finiq	Operacionet/Procesi		Hartimi dhe miratimi i Planit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë.	Grup pune Gjashtëmujori i parë 2026
4	Mungesa e Kodit të Sjelljes dhe Etikës për administratën e bashkisë.	Operacional/ Ligjor dhe Kontraktual	Mesatar	1. Hartimi dhe miratimi i Kodit të Sjelljes për administratën e bashkisë, duke përfshirë rregulla në lidhje me parandalimin dhe deklarimin e konfliktit të interesit, veprimtarive të jashtme, pranimit	Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse Drejtoria Juridike

				dhe deklarimit të dhuratave, si dhe deklarimit të pasurisë.	<i>Gjashëmujori i dytë i vitit 2025</i>
5	Mungesa e një strategjie të miratuar të administrimit të pronave bashkiake.	Operacional/ Strategjik	Mesatar	1. Hartimi, konsultimi, miratimi dhe publikimi i strategjisë së administrimit të pronave bashkiake.	Grup pune i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik Koordinatori për të drejtën e informimit <i>Gjashëmujori i parë i vitit 2026</i>
6	Mungesa e një plani vjetor trajnimesh për zhvillimin profesional të personelit të bashkisë sipas drejtorive dhe nevojave të evidentuara.	Operacional		1. Përcaktimi në Rregulloren e Brendshme i detyrimit për hartimin e Planit Vjetor të Trajnimeve. 2. Përcaktimi në Rregulloren e Brendshme i detyrimit për kryerjen e Analizës Vjetore të Performancës, si bazë për identifikimin e nevojave për trajnim dhe Hartimin e Planit Vjetor të Trajnimeve. 3. Hartimi i Planit të Brendshëm të Trajnimeve dhe Analizës së Performancës, çdo vit.	Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (Gjashëmujori i parë 2025)
7	Mungesë e rregullave të	Operacional	Mesatar	1. Hartimi dhe miratimi i rregullave	Drejtoria e

